



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot.

Shkodër, më ___/___/2023

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje tuajës nr. 19.326, datë 11.12.2023 “Kërkesë”, si më poshtë vijonë gjeni përgjigjet rreth kërkesave tuaja:

1. A është konsultuar me publikun Buxheti Vjetor 2023 dhe 2024 i Bashkisë? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e dëgjesave publike, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura, kopje të rekomandimeve dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.

Njoftim për konsultimin publik 2023 në kuadër të hartimit të Buxhetit 2023 dhe Programit Buxhetor 2024-2025 si dhe Procesverbalet e takimeve

https://bashkiashkoder.gov.al/k%C3%ABshillim_m_publicun/njoftim-per-keshillim-me-publicun-per-draftin-e-projektplanit-buxhetor-afatmesem-2023-2025/

Njoftim për konsultimin publik 2024 në kuadër të hartimit të Buxhetit 2024 dhe Programit Buxhetor 2025-2026 si dhe Procesverbalet e takimeve

https://bashkiashkoder.gov.al/k%C3%ABshillim_m_publicun/njoftim-per-keshillim-me-publicun-3/

Procesverbalet e dëgjesave publike 2024

https://bashkiashkoder.gov.al/k%C3%ABshillim_m_publicun/njoftim-per-keshillim-me-publicun-per-draftin-e-projektplanit-buxhetor-afatmesem-2024-2026/

2. A është konsultuar me publikun paketa e taksave dhe tarifave vendore për periudhën 2023-2024? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e dëgjesave publike, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura, kopje të rekomandimeve dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.

Në lidhje me pyetjen, ju informojmë që nuk ka patur ndryshime të paketës fiskale 2023.

Ndërkohë jëmi në proces të rishikimit të paketës fiskale 2024, si më poshtë linku i njoftimit të konsultimit publik.

https://bashkiashkoder.gov.al/k%C3%ABshillim_m_publicun/njoftim-per-keshillim-me-publicun-nga-keshilli-bashkiak/

3. A është konsultuar me publikun tjetërsimi i pronave të Bashkisë për periudhën Janar 2023-Dhjetor 2023? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e dëgjesave publike, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura, kopje të rekomandimeve dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.

Në lidhje me pyetjen ju informojmë që nuk ka patur tjetërsime të pronave gjatë periudhës Janar 2023 – Dhjetor 2023

4. A janë njoftuar paraprakisht në faqen e internetit ose stendën e informimit data dhe ora e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak për periudhën Janar 2023-Dhjetor 2023? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e këtyre mbledhjeve, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.

<http://209.95.59.218/~bsh/regjistr bashkiashkoder/regjistri-i-mbledhjeve-te-keshillit-bashkiak/>

5. A janë njoftuar paraprakisht në faqen e internetit ose stendën e informimit data dhe ora e mbledhjeve të Komisioneve të Këshillit Bashkiak për periudhën Janar 2023-Dhjetor 2023? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e këtyre mbledhjeve, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.

<https://bashkiashkoder.gov.al/plani-vjetor-i-vendimmarrjes/>

6. A shfaqen në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike, njoftime për organizimin e Dëgjesave Publike nga Këshilli Bashkiak për periudhën Janar 2023-Dhjetor 2023? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e këtyre dëgjesave, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.

<http://209.95.59.218/~bsh/regjistr bashkiashkoder/regjistri-i-projekt-akteve/>

7. A ka qenë Bashkia juaj ndonjëherë përfituese e Fondit Social që nga krijimi i tij dhe nëse po, sa ka qenë periudha për të cilën është ofruar mbështetje dhe në çfarë vlere monetare?

Bashkia Shkodër ka aplikuar pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën Nr. 4307 Prot., datë 10.12.2021 për Fondin Social për Shërbime me Bazë Komunitare 2022 me projekt – propozimin “Strehëz për fëmijët pa kujdes prindëror”, me qëllim sigurimin e

vazhdimësisë së financimit të Strehëzës për fëmijët pa kujdes prindëror, strukturë e ngritur nga Bashkia Shkodër në bashkëpunim me ACLI-IPSIA.

MSHMS në kuadër të aplikimit në Fondin Social të vitit 2022, ka përzgjedhur Bashkinë Shkodër fituese, sipas shkresës së dërguar me nr.7247 datë 06.05.2022. ku Bashkia Shkodër është përzgjedhur fituese e projekt-propozimit “Strehëz për fëmijët pa kujdes prindëror” në kuadër të fondit social 2022.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka transferuar fondin për projektin fitues të Bashkisë Shkodër më datë 11.05.2022, përmes shkresës me Nr. 2084 Prot., “Transferim fondesh për financimin e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashki për vitin 2022” dhe shkresës Nr. 69/43 Prot., datë 16.05.2022 e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Akordim i fondeve për financimin e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashki për vitin 2022”. Sipas aplikimit kohëzgjatja e projektit është 36 muaj (Janar 2022 – Dhjetor 2024), Nga buxheti i shtetit transferimi I fondit ne buxhetin e Bashkisë Shkodër është planifikuar të bëhet në tre këste:

- Financimi i vitit të parë në masën 90% të totalit të kostove të ofrimit të shërbimit, ku në fakt ky financim është disbursuar në maj të vitit 2022 në shumën **7,841,995** Lekë që përkon në mënyrë përpjësimore me 7 muaj shërbim.
- Viti i dytë i zbatimit të projektit do financohet në masën 60% të vlerës së projektit. **8,612.016** Lekë
- Viti i tretë i zbatimit të projektit do financohet në masën 30% ne Shumen **4,158,672** Leke deri sa shërbimi do të mbulohet 100% nga Bashkia Shkodër.

Bashkengjitur dokumentacioni në lidhje me Fondin Social.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin

Bashkia Shkodër